

Aktivitetet e kryera nga Shoqata “Multifunkionale për Kulture, Edukim dhe Zhvillim” në zbatim të nëngrantimit në kuadër të projektit “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”, mbështetur financiarisht nga Komisioni Europian.

1. Ngritja e mekanizmit të bashkëpunimit e bashkërendimit me institucionet përgjegjëse (Bashki, Media, Drejtoria e Migracionit dhe Kufirit, DSHP, OJF (CARITAS), Drejtoria Vendore e Policisë), pjesë e menaxhimit të migrantëve me qëllim për të vendosur urat e komunikimit mes institucioneve dhe për të patur ofrimin sa më efektiv të shërbimeve të tyre ndaj migrantëve.
2. Informimi dhe ndërgjegjësimi i migrantëve në risk dhe publikut të gjerë për t’u kontrabanduar përmes prodhimit dhe shpërndarjes së kronikave, fushatave mediatike, emisioneve dhe fletëpalosjeve. Fokusi më i madh i informimit do të jenë banorët e zonave kufitare që shkelen kryesisht nga migrantët dhe konkretisht në pikave të kalimit kufitar në Kakavijë, Dropull dhe Tri Urat, Përmet. Eksperti do të monitorojë dhe median lokale për sa i përket ruajtjes së identitetit të migrantëve të mitur, mënyrën sesi trajtohet rasti pa cënuar integritetin e tyre.
3. Migrantëve, me fokus kryesor grupet e marginalizuara ndër ta, do t’u jepet shërbim ligjor duke e vënë theksin jo vetëm te respektimi i të drejtave të tyre por dhe te risqet që i shoqërojnë gjatë lëvizjes së tyre migratore. Shërbimi ligjor do të konsistojë në dhënien e informacionit në mënyrë që mos bien pre e trafikimit, si dhe asistencë gjatë kohës së intervistimit. Gjithashtu migrantët do të njihen me ligjin për të huajt që ka të bëjnë me kthimin e tyre, pasojat për një qëndrim të paligjshëm, largimin vullnetar, kërkesën për Azil.
4. Eksperti psikolog do të ofrojë shërbime për të gjitha kategoritë e migrantëve. Ai do të asistojë gjatë procesit të intervistimit për të garantuar respektimin e të drejtave që j’u përkasin migrantëve dhe për të lehtësuar procesin e intervistimit nga specialistë të policisë. Për shkak të situatave që kanë përjetuar nga vëndet që vijnë si dhe incidenteve ku mund të jenë përfshirë gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit, migrantëve do t’u ofrohet këshillim dhe shërbim psikologjik. Fokusi kryesor i këtij shërbimi do të jenë gratë dhe fëmijët e pashoqëruar.